



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2023:274931

Datë: 11.04.2024

Numri i dokumentit: 05563912

C.nr. 961/2023

Gjykata Themelore Gjilan - Dega në Kamenicë, Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Artan Abazi, me bashkëpunëtorin profesional Irfan Thaqi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses H. M. nga, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Enver Ajvazi, avokat nga Kamenica, kundër të paditurës Komuna e Kamenicës-Drejtoria e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e shujtës ditore, shpenzimet e udhëtimit, për kualifikim – licencim dhe inflacion, me vlerë të kontestit 3,781.70 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë 11.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar në ligj kërkesëpadia e paditëses H. M. nga, dhe Detyrohet e paditura Komuna e Kamenicës, që paditëses në emër të ushqimit ditor, për 383 ditë pune, t’ia paguaj shumën prej 686.00 euro, edhe atë prej datës 14.09.2020 deri më datë 22.11.2022, për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, në lartësi 70% të biletës së udhëtimit, shumën prej 268.10 euro, kompensimin e diferencës në pagë për kualifikim shkollor – fakultet, në lartësi 27 % të pagës bazë për periudhën nga data 01.01.2020 deri më datë 31.12.2022, edhe atë për 34 muaj, shumën prej 1,881.90 euro, ndërsa në emër të inflacionit për vitin për vitin 2020, për 0.2% të inflacionit, shumën prej 10.10 euro, për vitin 2021 për 3.4% të inflacionit, shumën prej 156.60. euro, për vitin 2022, për 11.6 % të inflacionit, shumën prej 586.00 euro, këto në shumë prej 752.73 euro, e në shumë të përgjithshme të hollave prej **3,588.73 euro**, me kamatë ligjore prej 8%, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

II. Pjesa tjetër e kërkesëpadisë për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, në shumë prej 101.50 euro, dhe kompensimi në bazë të inflacionit për vitin 2020, në shumë prej 90.90 euro, Refuzohet si e pa bazuar.

III. Detyrohet e paditura, që paditëses t’ia paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore, në shumë të përgjithshme prej 144.00 euro, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

Arsy etimi

Paditësja, përmes të autorizuarit të tij, më datë 27.11.2023, ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Kamenicës-Drejtoria e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e shujtës ditore, shpenzimet e udhëtimit, të ardhurave në bazë të licencimit dhe inflacionit, me vlerë prej te kontestit prej 2,791.00 €. Në padi ka theksuar se e njëjti është në marrëdhënie pune te e paditura dhe është e licencuar. Baza ligjore lidhur me këtë kërkesë ka theksuar se gjendet në Kontratën Kolektive të Arsimit, neni 35, paragrafi 5, 7 dhe 10, dhe Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr. 01/33 të datës 29.08.2008, Udhëzimin Administrativ nr. 24/2014, nenin 21.

Përfaqësuesi i paditësit përmes parashtrësës për përcizimin e padisë të dt.16.02.2024 ka kërkuar nga gjykata që të detyrohet e paditura që paditëses që paditëses në emër të ushqimit ditor, për 383 ditë pune, t'ia paguaj shumën prej 686.00 euro, edhe atë prej datës 14.09.2020 deri më datë 22.11.2022, për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, në lartësi 70% të biletës së udhëtimit, shumën prej 369.60 euro, kompensimin e diferencës në pagë për kualifikim shkollor – fakultet, në lartësi 27 % të pagës bazë për periudhen nga data 01.01.2020 deri më datë 31.12.2022, edhe atë për 34 muaj, shumën prej 1,881.90 euro, ndërsa në emër të inflacionit për vitin për vitin 2020, për 0.2% të inflacionit, shumën prej 101.00 euro, për vitin 2021 për 3.4% të inflacionit, shumën prej 156.60. euro, për vitin 2022, për 11.6 % të inflacionit, shumën prej 586.00 euro, këto në shumë prej 843.60 euro, e në shumë të përgjithshme të hollave prej 3,781.70 euro, këto me kamatë ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditë, pas datës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor. Gjykatës i ka propozuar të aprovojë si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses në shumat e lartëcekura. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar edhe atë 104.00 euro për përpilimin e padisë, 40.00 ne emër të taksës gjyqësore për padi.

Gjykata konform nenit 394, 395 dhe 396 të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në vijim: LPK-së) të paditurës i ka dërguar aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë dhe provat e bashkëngjitura padisë për tu deklaruar me shkrim në padinë e paditësit.

E paditura përmes përgjigjes në padi, ka theksuar se e kundërshton në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke shtuar se nuk është kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune të e paditura, mirëpo KKAK nuk është regjistruar në MPMS-së, ashtu siq kërkohet me Udhëzimin Administrativnr.12/2021, për regjistrimin e Marrëveshjeve Kolektive, nga ky fakt nuk prodhon efekt juridik, po ashtu ka theksuar se në bazë të Udhëzimit Administrativ nr.5/2017, “licenca për mësimdhënësit lëshohet për një periudhë 5 vjeqare ndërsa paditësi është me licencë të skaduar dhe të njejtit nuk kan zbatuar udhëzimin administrativ lidhur me vazhdimin e licencës. Po ashtu ka theksuar se Qeveria me rastin e nxjerrjes së këtij vendimi ka qenë e obliguar që të bëjë rritjen e të hyrave për komunat sidomos për komunën e Kamenicës, në kategorinë e pagave, i ka propozuar gjykatës që të refuzohet padia dhe kërkesë padia e paditësve për arsyet e cekura më lartë.Gjykatës i ka propozuar të refuzojë të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së) për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, pasi që nga përgjigja në padi rezulton qartas se padia e paditëses është pjesërisht e bazuar.

Gjykata, ka gjetur se mes palëve nuk janë kontestuese faktet se paditësja është në marrëdhënie pune pranë të paditurës, as paga bazë apo kompensimet e shtesave, por kontestues është fakti se a ka bazë ligjore për kompensim shujtës ditore, shpenzimet e udhëtimit, të kualifikimit-licencimit dhe inflacionit për paditësen. Nuk është kontestuese se paditësja është në marrëdhënie pune të e paditura dhe e njëjta nga data 14.09.2020 deri më datë 22.11.2022, ka gjithësej 383 ditë pune, në pozitën e mësimdhënës të kualifikuar me fakultet, (fakt i vërtetuar nga vërtetimi nr.298 i dt.29.11.2023, i lëshuar nga SHFMU “Dëshmorët e Kombit”, në Kamenicë, diploma nr.1056 e dt.12.08.2018); dhe se e njëjta për kualifikim-fakultet është paguar në shumën prej 58.32 € (për vitin 2020, 2021 dhe 2022), pagën bazë e ka në shumë prej 421.00 euro, fakt i vërtetuar nga lista e pagave). Ndërsa kërkesa e paditëses për shpërblimin në bazë të inflacionit, bazën ligjore e ka në nenin 35 paragrafi 10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë /Kontrata e datës 18.04.2017, ngase në nenin përkatës është përcaktuar se: “ Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë.”, e në rastin konkret gjykata e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses në të dhënat se shkalla mesatare vjetore e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, periudhën për vitin 2020, mesataren vjetore prej 0.20%, për vitin 2021, mesataren vjetore prej 3.4%, dhe për vitin 2022, mesataren vjetore 11.6 %.

Ndërsa duke u bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017, dhe KKAK-së të dt.22.01.2021, konkretisht nenin 35 paragrafi 7 të kësaj Kontrate, ku theksohet se “Të punësuarve, u sigurohen kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë për një ditë pune është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arismore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restorantit a kuzhinës ose në një formë tjetër nuk ka obligim kompensimin për ushqim”, në rastin konkret institucionet shkollore nuk e kanë të rregulluar ushqimin përmes restoranteve apo kuzhinave, andaj, e obligoj të paditurën që paditëses t’ia kompensoj për 383 ditë pune, shumën prej 686.00 euro, në emër të ushqimit për ditë e pranisë në punë, nga data 14.09.2020, e deri më datën 22.11.2022. Gjykata sa i përketë ditëve të pranisë në punë është bazuar në vërtetimin nr.298, i dt.29.11.2023, i lëshuar nga SHFMU “Dëshmorët e Kombit”, në Kamenicë, në emër të paditëses, ndërsa sa i përketë lartësisë së aprovuar për shujtën ditore, ka gjykuar kërkesat e palës paditëse, e që rrjedhimisht gjykata nuk mund të dalë jashtë kërkesave të palës paditëse.

Ndërsa sa i përketë shpenzimeve të udhëtimit për paditësen për 383 ditë punë, në lartësi 70% të biletës së udhëtimit, në shumë prej nga 268.10 euro, gjykata mori parasyshë dispozitën e nenit 35 parag.5 të KKAK, ngase paditësja jeton në fshatin Topanicë, ndërsa sa i përketë lartësisë së

kompensimit gjykata pati parasyshë kuponat fiskal të lëshuar nga N.T.P “Dalina”, ku çmimin i biletës së udhëtimit për një drejtim nga fshati Topanicë, për në Kamenicë, është 0.50 euro, rrespektivisht 1 euro, për dy drejtime.

Andaj, gjykata në këtë çështje kontestimore sa i përket të drejtave subjektive të paditëses dhe lartësisë së saj, ka zbatuar dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017 dhe Kontratës kolektive në fuqi të datës 22.01.2021, konkretisht nenin 5, 7 dhe 10 të kësaj Kontrate, si dhe Mendimit juridik me nr.prot.214/2023, të datës 09.10.2023, të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr.01/33 i datës 29.08.2008, ndërsa procedura është zhvilluar në bazë të Ligjit të Procedurës Kontestimore në fuqi.

Gjykata bazuar në nenin 329.1 të LPK-së, provat në shkresat e lëndës i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritore, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror – këtu vet e paditura, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Në Vendimin e Qeverisë, Nr.01/33 të datës 29.08.2008, i cili vendim ka qenë në fuqi deri më datë 06.02.2023 (i shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik, Nr.08/L-196), është përcaktuar se të gjithë mësimdhënësit do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit, pra mësimdhënësve, drejtorëve, zëvendësdrejtorëve dhe bashkëpunorëve profesional, përfitojnë rritje page me diplomë të shkollës normale 10 % të pagës bazë, me diplomë të shkollës pedagogjike me nje ngritje te pagës bazë prej 19%, me diplome universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35 %. Ndërsa në KKAK e datës 18.04.2017, në nenin 35 paragrafi 10 të Kontratës është përcaktuar se: “ Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë ”, në rastin konkret për vitin, 2020 , 2021 dhe 2022.

Zbatimi i këtij vendimi të Qeverisë, në rastet e kualifikimit-licencimit është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 214/2023 të datës 05.10.2023.

Në rastin konkret, gjykata vlerësoi se e paditura nuk ia ka kompensuar paditësit pagën sipas përqindjes për shkak të kualifikimit shkollor, përkatësisht me kualifikim- Fakultet, për vitet 2020, 2021 dhe 2022 sipas pagës bazë prej 42100 euro, ndërsa sipas përqindjes së përcaktuar në Vendimin e Qeverisë, është dashur të paguhen për 27 % të pagës bazë, me ç’rast i ka mbetur borxh paditësit në shumën prej 55.35 euro, për vitet 2020, 2021 dhe 2022, me ç’rast i ka mbetur borxh paditësit në shumën prej 55.35 euro, ndërsa në emër të inflacionit për vitin 2020, mesataren vjetore prej 0.20%, për vitin 2021, mesataren vjetore prej 3.4%, dhe për vitin 2022, mesataren vjetore prej 11.6% këto në shumë prej 752.73 euro.

Sa i përketë lartësisë së kërkesëpadisë për shumat e gjykuara dhe aprovuara, gjykata ka vendosur pa nxjerrë ekspertizë përkatëse për shkak të ekonomizmit të procedurës, shumat ishin të qarta dhe lehtë të kalkulueshme për gjykatën.

Nga këto arsye, gjykata detyroi të paditurën t’ia kompensojë shumën e përcaktuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në emër tëshujtës ditore, shpenzimet e udhëtimit, kompensimit të kualifikimit shkollor – përkatësisht diferencën e papaguar dhe inflacionit.

Nga të theksuarat më sipër, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Për kamatën, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së.

Gjykata pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditëses sa i përketë shpenzimeve të udhëtimit në shumë prej 101 euro, e refuzoi si të pa bazuar ngase paditësja ka gjithësej 383 ditë pune, duke i kalukuluar me lartësin e qmimit të biletës, na jep shumën si në pikën I të dispozitivit, ndërsa sa i përketë inflacionit për vitin 2020, në shumë prej 90.90 euro, gjykata po ashtu e refuzoi si të pa bazuar nga fakti se shkalla e inflacionit për vitin 2020 është 0.2% duke e kalkuluar me pagën bazë me muajt e vitit të kërkuar e këtë shumë na jep shumën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore nga neni 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e paditësit në këtë procedurë dhe kërkesën e specifikuar për këto shpenzime, ashtu që ia njohi kërkesën e shpenzimeve sa i përket përpilimit të padisë dhe taksës gjyqësore, si shpenzime të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjyq. Sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifar 6 të Rregullorës për Tarifën e Avokatëve të Kosovës.

Nga të lartëcekurat e bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 398 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA NË KAMENICË

Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil

C.nr.961/2023, më datë 11.04.2024

**Gjyqtari,
Artan Abazi d,v**

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit në Gjykatën e Apelit, përmes kësaj Gjykate.